



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 13046/2 Prot

Fier më, 27 / 11 /2025

PROCES VERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 27.11.2025. Sot në sallën e mbledhjeve ora 13:30. Të pranishëm në mbledhje 33 këshilltarë.

Znj. Antoneta Çunaj

Përsëritet të nderuar këshilltarë! Fillojmë mbledhjen e këshillit bashkiak, meqenëse është krijuar kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës me përmbajtjen si më poshtë:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 30.10.2025.
3. Projekt-vendim: : “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin tetor 2025.”
4. Projekt-vendim: : “Për miratimin e dhënies së një ndihme financiare prej 5000 lekë për 1200 familje në nevojë.”
5. Projekt – vendim: “Për miratimin e Strukturës dhe Nivelit të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Fier.”
6. Projekt – vendim: “Për miratimin e financimit të shpenzimeve të transportit të nxënësve të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025–2026, që udhëtojnë nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, në një largësi mbi 2 km nga institucionet arsimore publike më të afërta.”
7. Projekt – vendim: “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit “Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”.
8. Projekt – vendim: “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe miratimin e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së

subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij.”

9. Projekt – vendim: “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 143, datë 23.12.2024 ‘Për miratimin e Komisionit të Strehimit’.”

10. Projekt – vendim: “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasve Mateo Çepele dhe Drilona Guri, për dëmin e shkaktuar nga zjarri në banesën e shtetasit Mateo Çepele, ku jetonte si qiramarrëse znj. Drilona Guri, ngjarje e ndodhur më datë 05.10.2025, në lagjen Apollonia, Njësia Administrative nr. 4.”

11. Projekt – vendim: “Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave që kanë mbetur të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, si dhe për lidhjen e kontratave përpara noterit.”

12. Projekt – vendim: “Për miratimin e planvendosjes së pasurive që do të preken nga realizimi i projektit ‘Zgjerimi i varrezave publike, faza VII’, fshati Mbyet, zk. 2637. Njësia Administrative Portëz, Bashkia Fier, me qëllim fillimin e procedurave administrative të shpronësimit të pasurive.”

13. Diskutime dhe komente.

Znj. Antoneta Çunaj

Materialet besoj se ju kanë ardhur të gjithë në mënyrë elektronike. Kështu që hedhim në votim rendin e ditës . Kush është dakort ?

Pro 33 vota.

Kundra s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Znj. Antoneta Çunaj

Përveç rendit të ditës me përmbajtjen e mësipërme, kemi edhe një pikë shtesë.konkretisht:

Pika shtesë e rendit të ditës.


Projekt-vendim :“Për pranimin në shtëpinë e të moshuarve Fier të qytetares Naxhie Raman Canaj i datëlindjes 07.08.1955 lindur në Fier dhe banues në Povelç të Fierit”

Znj. Antoneta Çunaj

Kjo pikë shtesë ka ardhur në sekretarinë e këshillit pas datës së publikimit të rendit të ditës i cili u publikua pas mbledhjes së kryesisë së këshillit e cila u zhvillua më datën 17.11.2025.

Kush është dakort me futjen në rendin e ditës të pikës shtesë që sapo lexova?

2



Pro 33 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të datës 30.10.2025

Znj. Antoneta Çunaj

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.10.2025. Materiali u është dorëzuar të gjitha forcave politike, është firmosur prej tyre. Kush është dakort ?

Pro 33 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e tretë e rendit të ditës

Projekt -vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin tetor 2025."

Znj. Antoneta Çunaj

Fillimish le të flasi përfaqësuesi i bashkisë dhe më pas e kanë fjalën anëtarët e këshillit për diskutime nëse kanë.

Znj.Mirela Pitushi

Faleminderit e nderuar kryetare! Përsa i përket këtij projekt vendimi, është një fond që alokohet çdo muaj nga Bashkia Fier. Ky projekt vendim ka ardhur elektronikisht tek të gjithë ju të nderuar këshilltarë dhe për çdo problematikë apo çfarë do lloj pyetje që mund të keni, unë dhe specialisti përkatës jemi në pritje të sygjërimeve tuaja.

Z.Elvi Daka

Doja të bëja një sqarim të vogël. Sot është mbajtur edhe mbledhja e komisionit përkatës, ku janë parë dhe trajtuar të gjithë dokumentacionet që kanë të bëjnë me këtë projekt vendim. Kemi dy familje të reja që futen në skemën e 6% për gjendjen e dobët ekonomike përkatësisht:1. Aida Sokrat Hanaj nga Nja nr.3 dhe 2.Adriatik Faik Sanco nga NjA portëz .Nga kjo skemë largohet një familje për mbarim të afatit të riaplikimit në sistem përkatësisht familja e Qerime Njazi Zeqo NjA.Portëz. Anëtarët e komisionit nuk kishin kundërshtime dhe i paraqitet këshillit për miratim.

Znj. Antoneta Çunaj



A ka ndonjë diskutim tjetër? M.q.s nuk ka diskutime e hedhim për miratim. Kush është pro?

Pro 36 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për miratimin e dhënies së një ndihme financiare prej 5000 lekë për 1200 familje në nevojë.”

Znj. Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën nga administrata apo nga komisioni?

Znj.Mirela Pitushi

Kjo është një praktikë e përvitëshme që bëhet për të disatin vit, edhe këtë fundvit nga Bashkia Fier. Janë 1200 familje në nevojë që përlitojnë një shpërblim prej 5000 lekësh të reja për festat e fundvitit. Përcaktimi i këtyre familjeve është bërë nga administratorët social të Nj.A mbi bazën e kriterit të gjendjes ekonomike të tyre.

Znj. Antoneta Çunaj

Komisioni përkatës është mbledhur për këtë pikë të rendit të ditës?


Z.Elvi Daka

Po komisioni është mbledhur për këtë pikë të rendit të ditës, e shqyrtoi dhe listën me kujdes. Përgjithësisht emrat e familjeve ishin në përputhje me kriteret përveç 10 emrave të familjeve të cilët menduam të rishikohen nga ana e administratës për shkak të disa problematikave siç ishin: Gabimet në gjeneralitetet e emrave apo të gabimeve dhe pasaktësive në dokumentat e identitetit të tyre. Për këtë arsye mendojmë që lista të miratohet në parim dhe 10 emrat të cilat komisioni i ka gjetur me pasaktësi të rishikohen nga ana e administratës.

Z.Kreshnik Dapi

Edhe unë në cilësinë e kryetarit të grupit të këshilltarëve të PSD-së si dhe të sekretarit të Kryesisë së Këshillit, kam pak a shumë të njëjtat vërejtje me kolegun parafolës. Lista së pari na u vu në dispozicion me shumë vonesë dhe vetëm pas kërkesës së paraqitur nga ana ime pranë sekretarisë së këshillit, pasi edhe pranë kësaj sekretarie nuk ishte paraqitur në momentin e paraqitjes së projekt-vendimit përkatës nga ana e administratës së bashkisë. Së dyti, edhe unë vë re se lista kishte gabime si në emra si dhe në numrat dhe gërmat të kartave të identitetit. Gjithashtu lista ishte pa firmë dhe pa vulë.

Z.Armando Subashi



Më fal kryetare, të bëj një sqarim në lidhje me këtë projekt-vendim. Ky është një proces që është kthyer në një ritual të përvitshëm nga ana e bashkisë. Sikurse e kam thënë dhe në mbledhjet e viteve të kaluara, bashkia për të disatin vit me radhë ka vendosur që të ndihmojë familjet në vështirësi ekonomike me sa të ketë mundësi, në mënyrë që ato të kalojnë sa më mirë festat e fundvitit. Deri përpara disa viteve, nga ana e administratës përgatiteshin pako me ushqime, të cilat u shpërndaheshin familjeve në nevojë. U pa që kjo mënyrë nuk ishte dhe aq produktive, pasi shumica e familjeve nuk preferonin ato produkte që ne si administratë kishim planifikuar brenda pakove të cilat u shpërndaheshin atyre. Kështu që nga ana jonë u pa e udhës shpërndarja e një bonusi apo shpërblimi financiar në vlerën 5000 lekë të reja të cilën këto familje mund ta përdorin si të duan për të ndihmuar sado pak që edhe ato ti kalojnë festat e fundvitit sa më mirë. Për sa i përket pretendimeve dhe konstatimeve të këshilltarëve parafolës, unë mendoj që ne ta miratojmë në parim projekt-vendimin dhe listën bashkëngjitur, dhe nga ana e administratës të rishikohen dhe të korrigjohen emrat e gjetur me pasaktësi nga ana e komisionit.

Znj. Antoneta Çunaj

A ka ndonjë tjetër për diskutim në lidhje me këtë projekt vendim? Nuk ka . E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 33 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e pestë e rendit të ditës.


Projekt – vendim: “Për miratimin e Strukturës dhe Nivelit të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Fier.”

Znj. Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni për këtë pikë?

Z.Kreshnik Dapi

Përshëndetje! Në cilësinë e sekretarit të Komisionit të Ekonomisë, dua të them që komisioni është mbledhur date 20.11.2025 ne orën 13:00 me prezencën e keshilltareve Kreshnik Dapi, Morena Tushe, Algert Braka, Armand Caushi dhe e ka shqyrtuar me kujdes piken 5 të Rendit të ditës, paketën fiskale 2026.Me lejen tuaj gjej rastin të falendërojmë në emrin tim personal por edhe në emër të grupit të PSD-së dhe shume kolegeve të tjere ketu, si edhe në emër të përfaqësuesve të biznesit të cilëve i përkas edhe unë, drejtuesen politike të qarkut Fier Znj.Belinda Balluku,dhe grupin drejtues politik se bashku me te, nën kujdesin dhe vemendjen e tyre u morën në konsideratë me qindra kërkesa dhe ankesa të bera përgjate vitit 2024 dhe 2025 dhe pasi i dëgjuan me kujdes ankesat e biznesit kryesisht atij të vogël dhe të qytetarëve, bënë të mundur ushtrimin e presionit pozitiv mbi administratën e bashkisë për uljen e tarifave vendore gjë e cila është pasqyruar edhe në paketën fiskale në fjalë.



Komisioni siç e thashë më lartë pasi e pa materialin vendosi me unanimitet t'ja kalojë për miratim këshillit paketën fiskale.


Znj. Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën nga administrata? Po kryetar, vazhdoni.

Z.Armando Subashi


Përshëndetje edhe njëherë! Për sa i përket paketës së re, dua të ndalem vetëm tek ndryshimet në raport me paketën ekzistuese, sepse ato pjesë të paketës ekzistuese që nuk preken me paketën e re besoj që nuk është nevoja ti përmendim. Por është fakt që ne kemi ndërhyrë në paketën ekzistuese duke ulur tarifat sepse sigurisht është ajo që kemi thënë këtu bashkarisht, duke ulur tarifat e shërbimeve që ofron bashkia për një kategori biznesesh të caktuara. Kategoria e parë janë disa subjekte le të themi, që mund të jenë ose persona fizik ose persona juridik në disa fusha të caktuara, kryesisht një grup shitësish duke filluar nga produktet bazë ushqimore si buka , mishi ,bylmeti, peshku e produktet të tjera ushqimore , industriale etje të cilave u është ulur niveli i tarifave qoftë në qytet qoftë në NjA-të. Dhe në fakt , po të shikoni tabelën, ulja nga 15 mijë lekë që ka qënë në qytet bëhet 11 mijë lekë dhe nga 11 mijë lekë që ka qënë në Nj.A bëhet 6 mijë lekë, pra flasim gjithmonë për bizneset e ashtuquajtura të vogla të cilat bëjnë një xhiro deri në masën e 140 milion lekë të vjetra ose 14 milion lekë të reja. Ky është niveli i parë i subjekteve që ne kemi prekur me këtë ulje. Një kategori tjetër është ajo që pak a shumë kemi reflektuar edhe ndoshta në diskutime apo debatet këtu në këshill, lidhur me pjesën apo tarifën që kemi vendosur për zënien e hapsirave publike. Kemi patur një formulë në fakt, 10 mijë lekë për 6 muajt e beharit dhe 2 mijë lekë për 6 muajt e tjerë që mesatarja shkonte 6 mijë lekë ose 600 lekë të reja në muaj, dhe 500 lekë për Nj.A-të gjatë 6 mujorit të beharit dhe 100 lekë për 6 muajt e tjerë ku mesatarja i bie 300 lekë në muaj. Këtu kemi vendosur që të bëjmë një unifikim, edhe duke bërë një ulje, ku shkon 400 lekë në muaj në qytet për m², pra zënia e hapësirës publike, dhe 100 lekë në muaj në Nj.A për m². Por sigurisht ajo që unë dua të raportoj këtu para këshillit, është fakti që një pjesë e gjithë këtyre subjekteve që realisht kanë marrë leje për zënien e hapësirës publike, praktikisht edhe në kuadër të gjithë këtyre verifikimeve që janë bërë këto muajt e fundit , edhe në raport me këto, sigurisht që ne menjëherë mbas miratimit të kësaj pakete do tu dërgojmë të gjithë subjekteve një shkresë, në ditët e para të dhjetorit, ku do të fillojmë një proces verifikimi në janar për të gjitha ato sepse realisht për fat të keq edhe nga kontrollet që janë ushtruar për gjatë kësaj periudhe, nisur edhe nga ankesat që kanë ardhur nga qytetarë të ndryshëm, një pjesë e tyre edhe kanë abuzuar, për të qënë të hapur dhe të drejtëpërdrejtë edhe me këshillin sepse mund të ketë patur leje nga bashkia po themi për 10 m² kanë bërë dhe pagesën sigurisht, mbi bazën e kësaj tarife, por atje në realitet pastaj mund të kenë 15 apo 20 m² apo diçka më shumë. Kështu që ky është një moment tjetër që praktikisht vlen që ta diskutojmë dhe ta rregullojmë dhe ta disiplinojmë sepse nëse kërkon ose nëse mundësia në X vend, në X hapësirë publike është për 10 m² sigurisht që kaq duhet të jetë, sepse pastaj prishet i gjithë ai raporti, sepse e kemi thënë që ky është një moment i diskutueshëm midis le të themi atyre hapësirave që ne i konsiderojmë të gjithë si të tonat, të të gjithë qytetarëve, përgjithësisht trotualet apo sheshet e ndryshme, dhe le të themi krijimit të mundësive që ne këtu kemi vendosur për ti hapur një mundësi apo një dritare më shumë një grupi biznesesh që edhe ata të punojnë edhe të realizojnë të ardhura, edhe tu shërbejnë njerëzve edhe kështu me radhë. Pra kjo në vetvete është një lloj konflikti me këto që thashë, por gjetja e atij çelësi të artë që edhe qytetarët të mos pengohen, të mos bezdisen etje në këto ambiente të përbashkëta, por edhe ato biznese të punojnë edhe të nxjerrin disa të ardhura, sigurisht është një sfidë e vazhdueshme dhe sigurisht që duhet parë rast pas rasti sepse asnjëherë nuk mund të jetë e prerë me thikë që duhet bërë kaq edhe pikë. Sepse gjithmonë varet nga

6



situata konkrete, nga sheshi, nga gjerësia e trotuarit, nga pozicioni ku mund të jetë ambjenti apo hapësira që kërkohet të merret e kështu me radhë. Pra në këtë kuadër, ne do të fillojmë një proces verifikimi, dhe atje ku realisht ka patur edhe ankesa, sepse për hir të së vërtetës ka patur ankesa edhe për një sërë rastesh nga banorë, nga subjekte, ne do ta ndërpresim këtë leje apo këtë marrëdhënie që mund ta kemi patur për këto vite dhe sigurisht ato struktura të çmontueshme janë sepse kështu ka qënë ideja që në fillim, të çmontohen dhe ato hapësira të lirohen dhe të kthehen në funksion të njerëzve. Pjesën tjetër pastaj që do të gjykohet të vazhdojë, mendoj që rregullat të vazhdojnë të jenë strikte dhe siguisht aq sa kërkon dhe aq sa të jepet aq do të paguash dhe aq do të shfrytëzosh. Sepse kjo hilja që paguan për kaq dhe hapu pak më shumë, shto edhe tre tavolina atje, vendos edhe ca karrige më tutje atje, kjo nuk mund të funksionojë. Jo sepse bashkia humbet të ardhurat, sepse unë e kam thënë që të ardhurat që ne marrim nga hapësirat publike, janë pothuajse të papërfillëshme në raport me gjithë të ardhurat që realizon bashkia. Por ne zbatuam një politikë në atë kohë edhe për ti frenuar deri diku kërkesat e pajustificuara dhe për të mos hapur si një lojë që të gjithë pastaj të vinin dhe të kërkonin të zinin një pjesë të trotuarëve apo të lulishteve etje. Mgjith kjo ulje e tarifës sigurisht që do të shoqërohet siç e thashë me një kontroll më të rrept dhe me një procedurë pak më strikte që ne mendojmë të fillojmë që nga janari. Por ne për të mos patur problematika që në dhjetor do tu dërgojmë një shkresë për ti vënë në dijeni për verifikimin që do të fillojmë nga janari. Një moment tjetër që keni aty është pagesa e tarifave që paguajnë rëndomtë në këto dokumentat e përditëshme që lëshohen në bashki, duke filluar që nga kërkesat që bëhen për ato vetëdeklarimet, për kryerje punimesh që mund të bëjnë në banes ose në pronën e vet qytetarë të ndryshëm. Por këtu kemi bërë një diferencim, kemi bërë një ulje nga 5000 lekë në 2000 lekë për qytetarët dhe nga 10000 lekë në 5000 lekë për personat juridik. Sepse këtu jo vetëm qytetarët vijnë marrin një formular vetëdeklarimi, por këtu vijnë shumë subjekte të cilat fitojnë edhe punë publike dhe natyra e punimeve që do të kryejnë është e tillë që nuk ka nevojë as për leje ndërtimi as për deklaratatë paraprake por mud të jepet thjeshtë një formular vetëdeklarimi dhe mbi këtë bazë mund të vazhdojë punën. Kështu që prandaj ne kemi bërë edhe një diferencim, pra duke i ndarë në persona fizikë dhe persona juridik. Ose ka dhe raste të tjera ku punimet i marrin përsipër firmat e ndërtimit. Pra nqs këtu vjen dhe paraqet një kërkesë një subjekt, një firmë, sigurisht pagesa është diçka më e lartë sesa një person fizik që mund të paraqitet. Tani si përfundim, unë dua të them këtë që, ne kemi miratuar vjet në këtë kohë, paketën dhe parashikim ose plani që kemi patur vjet ka qënë rreth 910 milion lekë të reja që ne duhet të mbledhim për këtë vit që jemi aktualisht dhe që është duke u mbyllur. Unë dua t'ju raportoj që deri në 25 nëntor nga rakordimi i shifrave që kemi bërë me thesarin, pra janë një sërë të ardhurash që na vijnë nga shumë burime jo vetëm nga traifat, 916 milion lekë janw mbledhur, pra duke qënë se kemi edhe një muaj përpara dhe përgjithësisht dhjetori prap është një muaj "sulmi" le të themi, realizimi i të ardhurave do të jetë mbi normën që ne kemi parashikuar dhe vendosëm vjet. Pra deri në fund të vitit besoj që kjo shifër do të jetë akoma më e lartë. Ndërkohë ne kemi miratuar këtu në këshill edhe disa dokumenta që kanë të bëjnë me buxhetin në përgjithësi pra ku përfshihen edhe të ardhurat për vitet 2026-2027-2028 që janë ato buxhetet afatmesme me afat tre vjeçar. Dhe për 2026 plani që kemi miratuar këtu është 911 milion lekë, për 2027 është 913 milion lekë, për 2028 është 919 milion lekë. Pra për të treja vitet e ardhshme kjo vjen me një trend rritës, por sigurisht, nisur nga realizimi që kemi praktikisht deri sot, edhe 911 që ne mendojmë që të realizomë si të ardhura për vitin që vjen, praktikisht mendoj që është një shifër e pranueshme, me këmbë në tokë, nuk është shifër e ekzagjeruar apo që mund të jetë bërë për ato qëllimet që kemi diskutuar këtu që hajde rrisim nivelin që do të mbledhim me kaq, që të justifikojmë pastaj listën e investimeve që do të miratojmë ca ditë më pas e kështu me radhë. Pra besoj që buxheti është një buxhet me të ardhura realiste, pa ekzagjerime dhe sigurisht pastaj nëse vijnë disa lekë më shumë se këto që parashikojmë ne dhe që me çfarë parashikohet sigurisht që do të vijnë dhe shumë mirë, kjo pa dyshim do të jetë ndihmë por dhe do të

7



jetë vazhdim dhe tregues i asaj pune të mirë dhe korrekte që përgjithësisht është bërë këtu në mbledhjen e taksave dhe tarifave. Tani unë u ndala tek tarifat, sepse këtu kemi ndryshime realisht në disa kategori siç thashë, ndërsa në shtyllat e tjera të paketës, siç është taksa e pasurisë që zë dhe pjesën kryesore, aty besoj që roli i këshillit është zero sepse unë e kam thanë që taksat janë ato që përcaktohen me ligj dhe nuk është që këshilli ka shumë në dorë për të vendosur aty. E vetmja gjë që këshilli mund të vendosi është taksa mbi tokën bujqësore, ku normalisht ka të drejtën të uli apo të ngrejë nivelin e asaj që përcakton ligji, në masën deri në 30% në ulje dhe deri në 10% në ngritje në raport me atë shifër. Por që ne vazhdojmë të qëndrojmë në nivelet e vjetshme, në mos gaboj jemi në 10% më pak se niveli që parashikon ligji. Dhe këtu dua të sjell në vëmendje një moment shumë të rëndësishëm, ndoshta jemi e vetmja Bashki në Republikë, që ne nuk aplikojmë asnjë tarifë për fermerët lidhur me shfrytëzimin e rrjeteve ujitëse dhe vatitëse. Edhe pse bëjmë një punë kolosale përditë atje, ku përditë kemi një numër të konsiderueshëm njerëzish, ekskavatorësh, është një ndërrmarje e dedikuar për atë punë, që merret çdo ditë me këtë gjë, dhe këtu kemi shumë këshilltarë nga të gjitha krahët që janë përfaqësues edhe të Nj.A-ve dhe besoj jemi të ndërgjegjshëm për këtë që në gjithë këto vite puna që është bërë me pastrimin e kanaleve, ka qënë një punë kolosale dhe asnjë familje fermeri sot në gjithë këto vite ne nuk i kemi marrë as tarifën më minimale. Ka shumë bashki edhe nga këto që kemi kufitare këtu, por edhe nga pjesë të tjera të Shqipërisë që aplikojnë tarifë për vatitjen apo për kullimin e tokave bujqësore. Ne vazhdojmë të qëndrojmë në këtë nivel, dhe unë i qëndrojë idesë që prapë është e panevojshme që ne të vëmë tarifë në këtë gjë sepse sigurisht për kushtet që ndodhet fermeri dhe me problemet që ka fshati, padyshim që ne mund të vazhdojmë të sakrifikojmë në këtë pikë, pra ato të ardhura që mund të mblidheshin nga ajo dhe që mund të përdoreshin për të njëjtin qëllim sigurisht do të vazhdojmë ti mbulojmë me një pjesë të buxhetit të bashkisë dhe padyshim duke parë ato balancat e duhura dhe me investimet e tjera që do të duhet të kryejmë qoftë në fshat, qoftë në qytet. Kështu që mendoj që këto ishin pak a shumë disa nga momentet kryesore të ndryshimit të paketës sepse pjesa tjetër mbetet siç është, është ajo që u tha, që pak a shumë kemi pasqyruar në këto ndryshime edhe vërejtjet edhe sygjerimet edhe propozimet që na kanë ardhur edhe nga bizneset, kryesisht nga biznesi i vogël, edhe nga grupe interesi që herë pas here bëjnë propozime për uljen e tarifave por që mendoj që kemi bërë gjënë e duhur dhe duke patur parasysh që të ardhurat mund të kompesohen në tjetër drejtim. Besoj që jemi në rrugën e duhur këtu dhe ju ftoj që ta miratojmë këtë paketë dhe ndërkohë do të mblidhemi prapë pas pak ditësh besoj, për të miratuar buxhetin dhe planin e investimeve që me këto të ardhura por dhe nga të ardhurat që do të vijnë nga qeveria qëndrore të ecim me investimet që do të realizojmë për vitin që vjen. Kështu që falenderoj edhe komisionet për shqyrtimin dhe bashkëpunimin dhe shpresoj që paketa të kalojë me konsensus sot sepse nga informacionet që kam edhe nga grupet politike që janë në këshill nuk është se ka patur ndonjë vërejtje themelore për paketën që ju kemi propozuar. Shumë faleminderit!

Znj. Antoneta Çunaj

A ka ndonjë sqarim, ndonjë diskutim në lidhje me këtë pikë?

Z. Endri Jaupaj

Vetëm një pyetje kam, kryetar. Nqs ju kujtohet, para 10 viteve, sa kanë qënë të ardhuruar tuaja si bashki dhe sa janë tani që mund ti krahasojmë se aty mbase na del diçka që jemi në rrugën e duhur apo jo?

Z. Armando Subashi

Mbaj mend nëse i referohemi le të themi 2015, ku ishte viti i parë i krijimit të bashkisë së madhe, kam përshtypjen që ajo çka ne kemi mbledhur shkonte diku tek 47 apo 50 milion lekë të reja. Pra nga ai vit deri më sot pothuajse kemi dyfishim, pra 4.7 apo 5 po shkojmë rreth 9.2 miliard lekë të vjetra.

Znj.Antoneta Çunaj

Mqs nuk ka më diskutime e hedhim për miratim.Kush është pro?

Pro 33 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për miratimin e financimit të shpenzimeve të transportit të nxënësve të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025–2026, që udhëtojnë nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, në një largësi mbi 2 km nga institucionet arsimore publike më të afërta.”

Znj.Antoneta Çunaj

Komisioni është mbledhur në lidhje me këtë fakt?

Z.Kreshnik Dapi

Komisioni është mbledhur , sikurse e thashë dhe më parë, i ka parë materialet me kujdes dhe i ka gjetur të plota dhe i propozon këshillit për miratimin e kësaj pike.

Z.Armando Subashi

Më fal kryetare, kam një koment të shkurtër sepse mendoj që kjo është në interes të të gjithëve dhe në nderin tonë që jemi të gjithë këtu. Praktikisht ka një VKM ku nxënësit mbi 2 km nga vendbanimi, kompesohen nga fondet që vijnë nga qeveria qendrore. Ne kemi patur mjaft raste në bashki, ku lagje të caktuara brenda një fshati të cilat nuk konsiderohen fshat në kuptimin ligjor, sipas ndarjes administrative territoriale që parashikon ligji, janë më shumë sesa 2 km nga shkolla, por realisht nuk e përfitojnë atë kompesim që bëhet nga drejtoritë arsimore nëpërmjet asaj VKM-je. Në fakt është një vendim që e kemi marrë ne këtu në këshill që çfarë ngelet ose nuk e përfiton këtë gjë nga buxheti qendror, kemi marrë vendim që t'ja japim ne me buxhetin e bashkisë. Pra në thelb për të gjithë të tjerët që e përfitojnë është detyrim nga buxhetit qendror dhe kompesimin e marrin nga qeveria qendrore. Ndërsa për ata që nuk e përfitojnë për shkak apo për këto arsye teknike që i thashë më lartë, kemi ndërhyrë ne si bashki dhe në këto kushte kemi krijuar një barazi të plotë edhe në këtë drejtim. Kështu që mendoj që ta vazhdojmë këtë gjë sepse mendoj se është në nderin tonë që të vazhdojmë të japim këtë kompesim.

Znj.Suzana Numani

Në fakt ashtu duhet të jetë, më mirë të ketë qendra shkollash që të bashkojnë shkollat e tjera vartëse sesa ka shkolla me klasa kolektive. Ka ankesa prindërisht të cilat i dëgjojmë ne shpesh që punojmë në arsim për bashkimin e klasave. Ju e dini besoj që ka shumë shkolla në periferi që punojnë me klasa kolektive. Edhe

unë për këtë do të isha për sigurimin e transportit për të mënjanuar klasat kolektive se dhe bota kështu e ka. Kjo gjë të shikohet për çdo fillim viti shkollor.

Z.Armando Subashi

Kjo vendimmarrje në fakt i takon drejtorive arsimore, nuk është se vendos bashkia që të mbyllen apo jo klasat. Por edhe unë jam me mendimin tuaj. Pra nqs po të nisemi nga interesi i fëmijës gjithmonë në aspektin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, realisht do të ishte shumë mirë që ata fëmijë më mirë të sakrifikonin të shkonin pak më larg por atë mësim ta merrnin tamam sesa me klasa kolektive.

Znj.Antoneta Çunaj

Faleminderit kryetar për sqarimin. E hedhim në votim nëse nuk ka diskutime të tjera. Kush është pro?

Pro 33 vota

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka

Miratohet.

Pika e shtatë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit ‘Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij’.”

Znj.Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni për këtë pikë?

Z.Kreshnik Dapi

Atëhere kryetare. Komisioni është mbledhur më datën 19 me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve: Znj.P.Cina, Znj.D.Azizaj, Z.E.Daka, Z.Rr.Gjika, Z.K.Dapi, Z.E.Jaupaj, Znj.N.Sollaku, Znj.M.Pitushi , për shqyrtimin e pikave 7,8 dhe 9 të rendit të ditës. Për pikën 7 që jemi duke folur, komisioni vendosi që të linte në fuqi sistemin e vitit të kaluar të pikëzimit po ashtu edhe për vitin 2026 dhe doli me raport vendimmarrje “pro”, për ta kaluar për miratim në këshill.

Znj.Antoneta Çunaj

A ka ndonjë diskutim ? E hedhim në votim. Kush është pro?


Pro 33 vota

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka

Miratohet.

Pika e tetë e rendit të ditës.



Projekt – vendim: “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe miratimin e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij.”

Znj.Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni për këtë pikë?

Z.Kreshnik Dapi

Për pikën 8, komisioni duke marrë në shqyrtim referencat nga disa agjenci të licensuara imobiliare në qytetin e Fierit, vendosi këto vlera mesatare për subvencionin e qerasë, konkretisht: për banesë me qera garsonerë 13 mijë lekë në muaj, për banesë me qera apartament 1+1, 18 mijë lekë në muaj, për banesë me qera apartament 2+1, 22 mijë lekë në muaj, për banesë me qera apartament 3+1, 25 mijë lekë në muaj. Komisioni doli me raport vendimmarrje “pro” për ta kaluar në këshill.

Znj.Antoneta Çunaj

A ka ndonjë diskutim tjetër?

Z.Endri Jaupaj

Diskutimet i bëme atje dhe jemi të qartë, vetëm unë do të kisha këtë sygjërim. Kemi informacion për 1200 familje që i kemi identifikuar dhe që do ti ndihmojmë me këtë 5000 lekëshin për pjesën e festave aq sa të mundemi, por të identifikohen familje që me të vërtetë kanë nevojë për këtë bonusin e qerasë sepse nga diskutimet që u bënë në mbledhje ka rënë kërkesa për bonus qeraje dmth nuk vijnë qytetarë që ta aplikojnë. Edhe këtu gjej rastin që aty ku ne njohim, ti orjentojmë tek pjesa e të formuluarit të dokumentacionit për të aplikuar dhe ne ta kalojmë se duket pa kuptim. Këtej kemi 1200 familje që kanë nevojë dhe këtej nuk ka aplikime për bonus qeraje, numri i aplikimeve është shumë i ulët për bonus qeraje, kjo gjë është no sens.

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 33 vota

Kundra s’ka.

Abstënim s’ka


Miratohet.

Pika e nëntë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 143, datë 23.12.2024 ‘Për miratimin e Komisionit të Strehimit’.”

Znj.Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni përkatës?



Z.Kreshnik Dapi

Komisioni për pikën nëntë të rendit të ditës vendosi të bëjë zëvendësimin e anëtares Znj.Merita Bitri e cila doli në pension me Znj.Denisa Azizaj . Gjithashtu pjesë e komisionit është shtuar Znj.Natasha Sollaku si përfaqësuese e drejtorisë përkatëse në administratën e bashkisë.

Z.Endri Jaupaj

La dhe diçka Z.Dapi që e diskutuam në komision, apo do ta thuash më vonë?

Z.Kreshnik Dapi

Do ta them më poshtë.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush është pro?

Pro 33 vota.

Kundra s'ka .

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Z.Kreshnik Dapi

Mqs jemi në këtë pikë, në mbledhjen e këtij komisioni, me kërkesë të disa anëtarëve të kryesuar nga Z.A.Çuko, është kërkuar nga administrata e bashkisë ngritja e një grupi pune i cili do të kryej një verifikim dhe inspektim të situatës reale në bllokun e banesave sociale, për të parë problematikat dhe prezencën atje të banorëve. Është një kërkesë e anëtarëve të komisionit dhe njëkohësisht e anëtarëve të këshillit bashkiak.

Znj.Evis Sema

Kretare nuk jam e qartë. Kërkohet ngritja e një komisioni të përbërë nga këshilltarët për të bërë verifikimin në vend?


Z.Kreshnik Dapi

Atëherë që ta sqaroj. Në mbledhjen e komisionit, një nga kolegët tanë është ngritur me pretendimin që në bllokun e banesave sociale ka parregullsi, që fillojnë me mosprezencën atje të personave që e kanë kontraktuar, të cilët mendohet që në disa raste jetojnë dhe jashtë shtetit, tashmë janë larguar dhe fizikisht, ka problematika që kanë të bëjnë dhe me çështje të natyrës penale konsumim dhe gjëra të tjera, dhe në këtë kuadër ne bashkarisht si komision vendosëm ti kërkojmë fillimisht administratës dhe drejtorisë përkatëse një relacion të detajuar të gjendjes atje.

Znj.Evis Sema

Po këtë komisionin e verifikimit që të jenë këshilltarët bashkë me administratën për çfarë e doni? Nuk mund ta bëjë verifikimin Komisioni i Strehimit?

Z.Kreshnik Dapi

 12

Jo komision tjetër, do ngrihet një grup thashë, një grup pune , një grup inspektimi.

Znj.Evis Sema

Grup pune mbi komisionin?

Z.Kreshnik Dapi

Po pra, grup pune sepse dëshirojnë që të marrin pjesë edhe kolegë të tjerë këshilltarë.

Z.Arben Çuko

Ja të sqaroj unë diçka.

Z.Kreshnik Dapi

Ne fillimisht kërkojmë relacionin pastaj të tjerat.

Znj.Antoneta Çunaj

A ka patur ankesa?

Z.Arben Çuko

Sipas burimeve që kam unë, atje ka persona që jetojnë në Gjermani, në Amerikë dhe në vende të tjera të botës dhe është e papranueshme që nëse është një person vërtet hallexhi që kërkon të përfitojë atë banesë sociale dhe ata i mbajnë kot. Plus që edhe ka edhe problematikë tjetër, ka edhe persona që nuk kanë paguar qeranë dhe këtë duam të bëjmë, të bëjmë verifikimin. Mqs Znj.Sema thotë që në këtë rast kërkojmë të ngrihet komision mbi komision, të ngarkohet me këtë detyrë Komisioni i Strehimit.

Z.Kreshnik Dapi

Ne duam thjeshtë fillimish një relacion. Pastaj e shikojmë këtë në hapin e dytë. Mund të shkojmë ne si komision, një pjesë e jona ose krijojmë diçka tjetër. Po fillimisht na duhet ai relacioni.

Znj.Antoneta Çunaj


Po kryetar.

Z.Armando Subashi

Unë për vete jam shumë dakort me propozimin që është bërë, pastaj kjo është çështje teknike se kush komision do vijë , le të themi nga këshilli, këtë ndajeni ju, se kush nga ju do të vijë, pjesë e kujt komisioni është, por jam shumë dakort që atje ta bëjmë një kontroll të thelluar për këtë gjë. Ju e mbani mend që ne para disa muajsh sollëm këtu një listë me katër a pesë familje më duket se nuk e mbaj mend, që nuk paguanin, që kishim informacion që nuk banonin aty etje, që morëm një vendim në atë kohë. Se përjashtoj mundësinë që mund të ketë të tjera, shumë mirë e keni menduar, ajo është një situatë dinamike gjithë kohës, vlen që gjithë kohës të kontrollohet, të verifikohet, dhe nëse konstatojmë prapë raste të ngjashme, të vihet këtu, të marrim vendimin përkatës dhe ai që s'ka nevojë për atë shtëpi për çfarë do ta mbajë? Për t'ja dhënë me qera tjetrit? Se kështu na ndodh, ikte jashtë vet dhe ja jepte me qera tjetrit.

Z.Kreshnik Dapi

Atij i ndryshon edhe statusi ligjërisht duke ikur jashtë, sepse i ndryshojnë dhe të ardhurat për frymë ndryshon dhe rezidenca etje.



Znj.Antoneta Çunaj

Në parim jemi dakort, ta shikojë dhe administrata, dhe të arrijmë në një konkluzion se si do të kryhet ky verifikim së bashku me anëtarët e këshillit. Dhe ne në mbështetje të atij komuniteti jemi, që ato shtëpi sociale ti jepen personave që kanë nevojë dhe jo personave që siç u raportuan, nuk e di sa të vërteta janë, dhe nuk e di të jenë të vërteta, gjithë nga grupi i verifikimit do të verifikohet nëse personat që kanë marrë këto banesa, të verifikohet nëse u takojnë ato ose jo.

Pika e dhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasve Mateo Çepele dhe Drilona Guri, për dëmin e shkaktuar nga zjarri në banesën e shtetasit Mateo Çepele, ku jetonte si qiramarrëse znj. Drilona Guri, ngjarje e ndodhur më datë 05.10.2025, në lagjen Apollonia, Njësia Administrative nr. 4.”

Znj.Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni?

Z.Kreshnik Dapi

Komisioni është mbledhur me pjesëmarrjen e këtyre këshilltarëve: Z.K.Dapi, Z.R.Mehmetaj, Z.E.Jaupaj, Z.Rr.Gjika. Nga ana e administratës së bashkisë drejtori i Emergjencave Civile Z.N.Bani, të cilin e përhëndes si gjithmonë për korrektësinë dhe për saktësinë e dokumentacionit. U njohëm me të gjitha dokumentat, çdo gjë u miratua dhe raporti i vendimmarrjes është “pro”. Dua ti rikujtoj këshillit edhe kërkesën e mbledhjes së kaluar, se jemi në një situat shumë të rënduar me kërkesat e ndihmës ekonomike, qoftë të drejtëpërdrejtë, qoftë të natyrave të ndryshme. Zoti sekretar i këshillit, është mbajtësi i disa prej tyre të cilat i janë dërguar këshillit, kurse Znj.Cina Drejtoresha Ekonomike e bashkisë mban pjesën e kërkesave që i janë drejtuar bashkisë. Kërkesat kanë vazhduar të vijë edhe këtë muaj. Ne duhet të bëhemi koshient dhe të vetëdijshëm, të krijojmë një strukturë, ky është mendimi im dhe i shumë kolegëve, dhe në radhë të parë për ti trajtuar me dinjitet këto kërkesa. Pastaj vendimmarrja se do të dali “po” ose “jo” për tu trajtuar me ndihmën që kërkojnë është tjetër gjë, është një proces që zgjidhet rrugës. Ne duhet të krijojmë një tip komisioni të tillë Ad-hoc, mendojmë, me nëntë anëtarë si shembulli i Komisionit të Strehimit që funksionon perfekt, dhe e para ti presim këto kërkesa, ti shqyrtojmë dhe ti delegojmë nëpër drejtori dhe institucionet që duhet. Sa më shpejtë ta bëjmë aq më mirë është sepse në dijeninë time, numri mund të ketë vajtur mbi 100. Kështu që midis punëve të tjera që kemi në mbledhjen e dhjetorit, mirë do të ishte që ky komision, kjo strukturë të formohet, me qëllim që janari dhe viti i ri buxhetor të na gjej gati për ti dhënë ndihmë atyre që e meritojnë. Edhe një tërheqje vëmendje, kjo është fjala e fundit për sot nga ana ime. Siç e filluam që në fillim të mbledhjes, në cilësinë e sekretarit të kryesisë, kryetare siç kemi folur, dhe me porosi të sekretarit të këshillit, i tërheq vëmendjen kryetarit të bashkisë, administratës dhe nënkryetarëve për prurjen e dokumentacionit në kohë dhe të plotë për mbledhjet e kryesisë me qëllim vazhdimin më tutje me rendin e ditës. Ne e shikojmë që ardhja e nënkryetarëve dhe strukturës së re e ka fuqizuar shumë bashkinë e Fierit, me mirëkuptim pranojmë dhe vonesa dhe gjëra që mund të vijnë pa vullnet dhe pa dashje, por e mira do të ishte që të ushtrohet presion pozitiv mbi administratën që gjërat të vijnë në kohë që të jemi konform rregullores. Dhe e fundit, i lutem kryetarit dhe sekretarit të përgjithshëm, të na vëri në dispozicion një ambjent tjetër për sekretariatit të këshillit, jemi në emergjencë për vete, për vendet, nuk kemi vend, zonja kryetare je dëshmitare, për të bërë mbledhjen e kryesisë, nuk kemi një tavolinë ku të shkruajmë

procesverbalin, nuk kemi një kompjuter dhe një printer për të punuar. Zyra ngjitur me sallën e këshillit është magazinë e cila mund të përdoret shumë mirë si sekretariat, pasi e ka kryer më parë një funksion të tillë. Ne do të presim me durim, por në pafundësi nuk do të presim. Nuk e kërkoj më këtë gjë. Kërkoj falje që u zgjata por është për të mirën tonë të përbashkët.

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim pikën dhjetë të rendit të ditës. Kush është pro?

Pro 33 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave që kanë mbetur të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, si dhe për lidhjen e kontratave përpara noterit.”

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën? Po Endri.

Z.Endri Jaupaj

Në dijeninë time ka më shumë se sa këta dy qytetarë që janë paraqitur në projekt-vendim, dhe unë kam folur me përfaqësues të bashkisë, do të ishte më mirë që të shqyrtoheshin të gjithë.

Znj.Antoneta Çunaj

Po Znj.Kapllanaj

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Një sqarim. Këto procedura që ju janë servirur janë procedura të përfunduara privatizimi, të bëra nga ndërrmarja e Entit të Banesave, kanë shkuar në ASHK, por nuk janë legalizuar përpara noterit, pra dhe duhet të përfundohet përpara noterit. Pra nuk janë procedura që kryhen nga ne, ndërsa këto kërkesa që ju thoni janë procedurë e pastër privatizimi që duhet të kryhet nga komisioni i privatizimit.

Znj.Antoneta Çunaj


Pra janë dy gjëra të ndryshme Z.Jaupaj. Është një procedurë e cila ka mbetur e papërfunduar pasi nuk është firmosur përpara noterit, por është mbyllur si procedurë privatizimi, është tjetër gjë kjo Endri.

Z.Endri Jaupaj

Është ngritur komisioni i privatizimit?

Znj.Esmeralda Kapllanaj

15



Po, komisioni është ngritur, por do të bëhen verifikimet përkatëse të dokumentacionit dhe procedurës dhe më pas do të vendoset rast pas rastit.

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim për miratim pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës. Kush është pro?

Pro 33 vota.

Kundra s'ka .

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për miratimin e planvendosjes së pasurive që do të preken nga realizimi i projektit ‘Zgjerimi i varrezave publike, faza VII’, fshati Mbyet, zk. 2637, Njësia Administrative Portëz, Bashkia Fier, me qëllim fillimin e procedurave administrative të shpronësimit të pasurive.”

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën? Po kryetar.

Z.Armando Subashi

Shumë shkurt sepse kjo është një histori e vazhdueshme në këshill, për fat të keq në fakt, që ne në periudha të caktuara kohe, çdo 6 apo 8 muaj vijmë këtu dhe kërkojmë zgjerimin e sipërfaqes së varrezave, duke patur parasysh momentet kur është ndërhyrë atje besoj se kjo është faza e shtatë dhe ndoshta përfundimtare sepse atje ka një vendim të KRRT-së, e cila e ka miratuar gjithë atë zonë për varrezat publike të Fierit dhe gradualisht në periudha të caktuara kohore ajo ka ardhur duke u zgjeruar. Tani nga ajo që ne krahasuam, gjithë planvendosjen dhe hartën që është miratuar që në ato vite me gjëndjen faktike, kjo është pothuajse pjesa e fundit që kishte mbetur pa u shfrytëzuar, por që është brenda asaj planvendosje që është miratuar me vendim të KRRT-së së Republikës së Shqipërisë. Kështu që besoj me këtë fazë, ne e ezaurojmë gjithë atë sipërfaqe toke që është lënë në përdorim dhe pastaj kur të përfundojë kjo nuk e di se çfarë do të vendosim. Por sipërfaqja që propozojmë kësaj radhe është mjaft më e madhe realisht dhe në fakt është ngjitur, duke shmangur edhe ato pjesët sipër që kemi shpronësuar edhe herët e fundit, sepse sa më lart të shkojmë aq më shumë bëhet edhe për njerëzit më e vështirë dhe terreni ka vëshirësitë e veta, edhe shpenzimet shtohen për rrugën etje. Por këtu jemi realisht diçka më poshtë dhe sot sigurisht një vendim në parim do të marrim dhe pastaj i takon ekzekutivit që nëpërmjet dy grupeve të punës që do të ngrihen që të hënë ose të martën, të bëjnë punën për përfundimin e gjithë dokumentacionit dhe mbledhjen e radhës, pastaj ne të marrim vendimet konkrete. Dy grupet e punës do të jenë: Një do të jetë ai grupi që ngremë gjithmonë i cili mbi bazën e marrjes së statusit të pronave që janë aty , të bëjë vlerësimin e dëmshpërblimeve që do të marri çdo person që ka pronë tokë ose ullinj ose ndonjë pemë frutore. Të bëjnë llogaritjen dhe

rrugët por që shpesh herë varrimi i personave të ndryshëm është bërë vend e pa vend. Pra ta kuadratojmë atë, të ndajmë kush do të jetë si rrugë kryesore dhe kush do të jetë rrugë dytësore apo tretësore me qëllim që edhe të krijojmë një pamje më të mirë dhe më të plotë por edhe ajo që është më e rëndësishmja të krijojmë funksionalitet dhe të shfrytëzohet maksimalisht dhe në mënyrë të rregullt e gjithë ajo sipërfaqe që synojmë të shpronësojmë. Pra tabela përfundimtare që do të vijë dhe projekti final i zbatimit 2, mund edhe të shoqërohet edhe me një vlerë të përafërt investimi sepse edhe ato rrugët që mendojmë të bëjmë aty, sigurisht që kanë vlerë investimi që do të duhet që nga krijimi i bazamentit, pastaj do ti bëjmë me asfalt apo me beton, është një diçka që e diskutojmë më vonë, por që janë të gjitha investime që praktikisht duhen bërë për të krijuar aksesin e duhur. Kështu që, prandaj them që të marrim një vendim në parim sot, të autorizojmë ekzekutivin që të vazhdojë me procedurat dhe në mbledhjen e dhjetorit ti mbyllim si dokumenta bazë dhe i përcjellim pastaj për në Agjencinë Shtetërore të Shpronësimeve, për të vazhduar më pas me daljen e VKM-së përkatëse për të përmbyllur përfundimisht shpronësimin e atyre familjeve.

Znj.Brunilda Sota

Po djegia parashikohet si mënyrë për kryerjen e procedurës së varrimit tek ne kryetar?

Z.Armando Subashi

Tani për djegien, edhe nga shumë tryeza që janë zhvilluar, sepse realisht problemi i vend varrimeve është një problem që ekziston në shumë bashki, sidomos në bashkitë e mëdha. Sot që flasim, djegia nuk është një opsion për momentin në Shqipëri, për hirë të së vërtetës edhe për shkak të kulturës apo traditës sonë.

Z.Endri Jaupaj

Gjërat ndryshojnë, kryetar. Edhe shtëpitë funerale nuk kanë qënë kulturë, por janë bërë, kështu që të mendohet njëherë pjesja e varrosjes murale, sepse po të vendosen opsione dhe tarifa, njerëzit pastaj vendosen përpara disa zgjedhjeve dhe bëjnë zgjedhjen e tyre.

Z.Armando Subashi

Por këtu, se është kollaj të diskutosh, por mos të harrojmë që ndoshta është një nga problemet me ndjeshmërinë më të madhe për çdo qytetar, dhe padyshim që nëse do të ndërmeret ndonjë hap jashtë ose ndryshe nga gjithë ajo që është bërë këto vite, nuk mund të merret as apriori as me forcë as me detyrim. Pra në qoftë se nuk ndryshon në mendje gjëja është e kotë që të diskutojmë ne këtu. E ke ti detyrim si shtet thotë qytetari, gjeje tokën dhe krijoje një varrezë të re, unë dua ta varros babanë dhe kaq, nuk dua as ta djeg dhe as ta vë në mur. Ç'farë do të bëjmë?

Z.Sajmir Kazanxhiu

Mqs jemi brenda temës për varrezat, bashkia Fier ka një drejtor që e kemi aprovuar edhe këtu. Do të ishte mirë që kjo drejtori të merrej dhe me zonat rurale. Në Baltëz psh vetëm rruga ka ngelur për varrezat, vetëm ti varrosim në rrugë tani, nuk ka vend fare, dhe duhet parë me prioritet në të gjitha fshatrat sepse jo vetëm në qytet por edhe fshatrat i kanë këto probleme.

Z.Armando Subashi

Tani ajo që kemi thënë këtu prandaj edhe ne gjykuam që të krijojmë një ndërrmarje më vete dhe që varrezat publike ti nxjerrim si ndërrmarje më vete dhe këtu nuk kam parasysh vetëm qytetin, sigurisht, kam parasysh edhe fshatrat gjithë nëpër fshatra shpesh herë ndodhemi përballë historive absurde, sepse ne po

diskutojmë këtë që po themi por ne kemi fshatra që kanë katër palë varreza, varreza me fise, varreza me mbiemra etje. Pra janë disa gjëra të cilat nuk shkojnë edhe atje. Për këtu ndoshta duhet të tregohemi më të vendosur dhe të mos lejojmë, sepse në fund të fundit ka dhe një ligj për mbrojtjen e tokës bujqësore. Pra nqs kjo zonë është e definuar që do të jetë varreza e fshatit atëherë ka ardhur momenti që ndoshta edhe me pak detyrim të heqin dorë nga këto historitë e varrezave të fiseve, lagjeve etje. Por edhe në fshatrat të cilat i kanë të përqëndruara varrezat, duhet ndërhrë sepse kjo pastaj na krijon edhe ne lehtësi për të bërë investime. Nqs kemi filluar proces rrethimi si moment të parë, dhe bëjmë atë pastrimin, krasitjen me ata 3-4 punëtorët që kemi lënë për çdo Nj.A, me ndërrmarjen e re që do të krijojmë mund të shkojmë edhe më tej, të shikojmë mundësinë e investimeve pak më të plota në varrezat edhe të fshatrave. Dhe ajo që ndoshta vlen të diskutohet në mbledhjen tjetër është edhe ky fakti tjetër se sot ne kryejmë shërbimin, një pjesë të shërbimit të varrimit e kryejmë në qytet me disa nga punonjësit tanë që kemi atje kundrejt një tarife që është 80 mijë lekë të reja, por në fshat sot jemi inekzistent. Sot në fshat të gjitha shërbimet, që nga hapja e gropës e deri në fund për fat të keq i bëjnë kompanitë private, ndërkohë që ka ardhur momenti që edhe këtë duhet ta shikojmë. Sigurisht një pjesë të atyre shërbimeve kompanitë private do ti bëjnë, Por ato që bëjmë në qytet me punonjësit e bashkisë, duhet të fillojmë të mendojmë që ti bëjmë dhe në fshat, dhe kjo do të uli një pjesë të pagesës që njerëzit bëjnë sot nëpër kompanitë private, duke vendosur sigurisht një tarifë aq sa mund ta kemi në qytet. Ajo është një tarif që thjesht mbulon shpenzimet që ne bëjmë atje, nuk është një tarifë që ka për qëllim që të fitojë bashkia nga ajo sepse ajo është një gjë qesharake. Praktikisht një lloj tarife të tillë mund ta vendosim, duke ofruar shërbim, sepse po nuk ofrove shërbim nuk ke çfarë kërkon edhe ndoshta në fshatra. Duke filluar me fshatrat e mëdha dhe më kryesoret, që I kanë edhe varrezat e përqëndruara, dhe duke u shtrirë pastaj gradualisht edhe në pjesën tjetër të fshatrave. Por për këtë jam dakort, që nëpërmjet administratorëve tanë në Nj.A dhe nëpërmjet ndërrmarjes së re që do të krijojmë, duhet të fillojmë gradualisht të vendosim edhe kontrollin mbi varrezat e fshatrave dhe jo të hapet gropa atje ku do X apo Y apo ku do ajo shoqëria private e cila po ti japësh dy lekë më shumë ta çon tek vendi që do, po nuk i dhe të sposton atje matanë e histori të tjera si këto. Pra normalisht unë jam shumë dakort që edhe këtu të vendosim një lloj rregulli. Për pos investimeve pastaj, se ajo sigurisht që qëndron edhe pjesa e rrethimit, edhe pastrimi, edhe krijimi i rrugëve të aksesit brenda e kështu me radhë.

Znj.Antoneta Çunaj

Po, faleminderit kryetar! E hedhim në votim pikën dymbëdhjetë të rendit të ditës, pasi ky është një miratim në parim sikurse e shpjegoi edhe kryetari. Kush është pro?

Pro 33 vota.

Kundra s'ka .


Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika shtesë e rendit të ditës.

Projekt-vendim :“Për pranimin në shtëpinë e të moshuarve Fier të qytetares Naxhie Raman Canaj i datëlindjes 07.08.1955 lindur në Fier dhe banues në Povelç të Fierit”

Znj. Antoneta Çunaj



Kush është dakort?

Pro 33 vota.

Kundra s'ka .

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Z.Armando Subashi

Keni pyetur, ka vend bosh në azile?

Znj.Mirela Pitushi

Po kryetar, ka vende bosh prandaj e kemi sjellë këtu për miratim

Znj.Antoneta Çunaj

E ka verifikuar administrata, kryetar.

Znj.Antoneta Çunaj


Me kaq mbledhjen e deklarojë të mbyllur duke ju falenderuar për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin!

Ky procesverbal ka 19 (nëntëmbëdhjetë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit

Z. Arnando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Arnando Çupa



fshillfer
Armando Çupa
Armando Çupa
Armando Çupa

Armando Çupa
Armando Çupa

KESHILLIT

Armando Çupa

Armando Çupa

Kryetar i Këshillit

Antoneta Çunaj

